

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. D.p. Dep.	DPKI
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	06-02/4728/22
Nr. Fiq. Br. Etr. Nr. Page.	02
Date Datum Date	02.12.2022
PRISHTINË	



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
 THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 01.12.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-3478/22, për zyrtarin e lartë z. Shemsi Jashari, Menaxher i Departamentit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Shemsi Jashari, krahas ushtrimit të funksionit publik Menaxher i Departamentit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, është edhe Drejtor Ekzekutiv në Organizaten joqeveritare “Rrjeti i organizatave joqeveritare lokale demokracia fillon këtu” si dhe person i autorizuar në biznesin privat “Grajzi Consulting” Sh.P.K.

Agjencia, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është mbajtur takim me zyrtarin e lartë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Gjatë këtij takimi z. Shemsi Jashari, është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit me ushtrimin e funksionit publik. Zyrtari i lartë z. Jashari nuk është pajtuar me konstatimin e Agjencisë lidhur me dispozitën e nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë Drejtor Ekzekutiv në Organizata joqeveritare, për faktin se një situatë e tillë paraqet gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në të cilën shprehimisht thuhet se: *“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës,*

veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Po ashtu, zyrtari i lartë nuk mund të ushtroj edhe funksionin e personit të autorizuar në biznes privat sepse kjo ndalohet me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në të cilën shprehimisht thuhet;

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare nr.(06-3793-1/22) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni Drejtor Ekzekutiv në organizatën joqeveritare “Rrjeti i organizatave joqeveritare lokale demokracia fillon këtu” si dhe nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat “Grajzi Consulting” Sh.P.K.

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

